



Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjtet, Çohu!

2027

2027

2027

**Plani
Strategjik
2022-2027**



Organizata për Demokraci,
Antkorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!

Rruga: Fehmi Agani 21-5; Prishtinë,
Kosovë

Tel / +383 (0)38 248 506

www.cohu.org



Qëllimi ynë ka qenë gjithmonë të ofrojmë alternativat, programet dhe rekomandimet më të mira të politikave për integritetin e institucioneve dhe luftën kundër korrupsionit në institucionet publike. Ne jemi krenarë që përpjekjet tona kanë shënuar ndryshime konkrete, përmirësime dhe transparencë në disa aspekte të jetës institucionale. Angazhimi dhe vlerat tona të përbashkëta me qytetarët, mediat dhe partnerët e shoqërisë civile kanë formësuar identitetin tonë dhe vazhdojnë të jenë forca jonë shtytëse. Së bashku, ne synojmë të shkojmë për më shumë. Më shumë integritet, më shumë transparencë, më shumë llogaridhënie. Kjo është ajo për çka ekziston COHU! Ky është vizioni dhe misioni ynë si dhe angazhimi ynë i ardhshëm”.

Arton Demhasaj, Drejtor Ekzekutiv

1.	Identitet dhe trashëgimi	07
<hr/>		
2.	Qëllimet e Planit Strategjik	08
	2.1 Metodologjia	
<hr/>		
3.	Misioni dhe Vizioni	09
<hr/>		
4.	Dimensionet Kryesore të Angazhimit	10
	a) Dimensio­ni Konceptual.	
	b) Dimensio­ni tematik.	
	c) Dimensio­ni strukturor.	
<hr/>		
5.	Shtyllat tematike (Programet)	12
	Shtylla e Parë: Drejtësia	
	Shtylla e Dytë: Anti-Korrupsioni dhe luftimi i krimi­ti të organizuar	
	Shtylla e Tretë: OPEN DATA.	
	Shtylla e Katërt: Gazetaria Hulumtuese	
	Shtylla e pestë: Qeverisja e mirë	
<hr/>		
6.	Zhvillimi i kapaciteteve dhe pronësia	15
	6.1 Analiza e palëve të interesit	
<hr/>		
7.	Pas Strategjisë	16
<hr/>		

1. Identitet dhe trashëgimi

Ky dokument përfaqëson planin strategjik për periudhën pesëvjeçare (2022-2027) të Organizatës për Demokraci, Anti-Korrupsion dhe Dinjitet-ÇOHU.

Organizata është e vendosur në Prishtinë, Republika e Kosovës, si dhe operon në sektorin e shoqërisë civile që nga viti 2005. Gjatë aktivitetit dhe veprimtarisë së saj, ajo ka arritur të ndërtojë një kauzë të fortë të angazhimit në lidhje me çështjet institucionale, duke u fokusuar kryesisht në luftimin e korrupsionit dhe krimeve në sektorin publik, relacionit të parasë publike me pasurimin e paligjshëm, monitorimin dhe avokimin për efikasitetin e sistemit gjyqësor në rastet kundër korrupsionit dhe krimeve të lidhura me detyrat publike.

Angazhimi i COHUt për të përmirësuar sundimin e ligjit dhe politikën anti-korrupsion, si në aspektin legjislativ ashtu edhe në masat ekzekutive, ka qenë trashëgimia e saj kryesore për më shumë se një dekadë, duke mbajtur në portofolin e vet, debatet dhe aktivitetet kapitale në segmentet kryesore publike që u përballen me korrupsionin përgjatë viteve.

Brenda kësaj tradite, COHU ka arritur të punojë dhe t'i përmbahet kapaciteteve të qëndrueshme profesionale, rrjedhimisht, një vizioni afatgjatë i cili është manifestuar në shumë dokumente dhe strategji.

Me planifikimin e duhur strategjik dhe punën e vazhdueshme në baza të rregullta drejt zbatimit të qëllimeve kryesore, COHU ka arritur të realizojë projekte dhe nisma të rëndësishme, të tilla si monitorimi i rregullt i punës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial, themelimi i gazetarisë hulumtuese dhe publikimi i të dhënave dhe gjetjeve në një platformë elektronike të hapur dhe të qasshme nga mediat, OJQ -të, institucionet publike dhe qytetarët.

Ndër vite, COHU ka zhvilluar dhe zbatuar projekte dhe aktivitete jo vetëm në kontekstin lokal por edhe jashtë tij, në bashkëpunim rajonal me organizatat dhe forumet e shoqërisë civile.

Një aspekt kritik i vlerave të përbashkëta të COHUt, ka qenë koordinimi dhe partneriteti përtej financimit, me komunitetin e donatorëve dhe palëve të interesit, i cili ka vazhduar të sjellë ndryshime, rezultate dhe hapje të perspektivave të reja në angazhimin civil.

Deri më tani, puna dhe angazhimi i COHUt është realizuar në përshtatshmëri me ngjarjet dhe zhvillimet shoqërore, krahas analizave, hulumtimit, avokimit dhe zbatimit të planeve strategjike në periudha të mesme kohore, zakonisht tre deri në pesë vite.

Trendët aktuale në sektorin e shoqërisë civile, të përcjella me përfundimin e afatit kohor të strategjisë së mëparshme, ka nxitur COHU-n që të rishikojë planifikimin e saj strategjik, në mënyrë që të vazhdojë punën dhe të përshtatet me nevojat aktuale, në përputhje me dinamikën socio politike dhe institucionale në Kosovë.

Për më tepër, një planifikim strategjik ka qenë i nevojshëm në mënyrë që të korrespondojë me ndryshimin shoqëror që ndikon sjelljen institucionale, duke marrë parasysh faktorët e nxitur edhe nga Pandemia COVID19, e cila si në të gjitha sferat e shoqërisë, ka ndikuar edhe në perspektivën zhvillimore të sektorit të shoqërisë civile.

Në drejtim të kësaj, duke ndjekur orientimin organizativ dhe strategjik drejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave të veta, stafi i COHU-t, muajve të fundit ka kryer një planifikim strategjik për 5 vitet e ardhshme.

Ky dokument përfshinë komponentët kryesorë të planit strategjik, duke përfshirë fushat tematike të interesit, organizimin strukturor dhe avancimin e përpjekjeve aktuale për të mundësuar një qeverisje të drejtë, transparente dhe respektuese të ligjit, sundimin e rendit dhe ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe integritetin e institucioneve publike, si dhe qytetarinë aktive.

2. Qëllimet e Planit Strategjik

Qëllimet kryesore të këtij plani strategjik janë të përafuara me pesë parimet kryesore që pasqyrojnë nevojat e COHU për periudhën e ardhshme. Ato përfaqësojnë shtytjen e organizatës drejt qëndrueshmërisë afatgjatë dhe pronësisë së plotë. Në këtë rrafsh, qëllimet e përcaktuara për t'u realizuar nga ky plan janë si më poshtë:

- a) Mbajtja e aktivitetit të përditshëm që udhëhiqet drejt një vizioni më të madh
- b) Ndërtimi një partneriteti më të qëndrueshëm me partnerët dhe palët e interesit në kohë të ndryshimeve dhe dinamikave aktuale;
- c) Profilizimi dhe organizimi strukturor për të përmirësuar efikasitetin;
- d) Ndërtimi i koherencës së projekteve të ndryshme për tu siguruar që të gjitha janë duke u udhëhequr së bashku;
- e) Identifikimi i prioriteteve dhe fokusi përpjekjeve për t'i realizuar ato në linje me misionin dhe vizionin e organizatës.

2.1 Metodologjia

Metodologjia e aplikuar gjatë hartimit të planit strategjik, është udhëhequr nga dy parime kryesore:

- a) Analiza e thelluar e çështjeve aktuale që bien brenda objektivave dhe misionit të COHU;
- b) Avancimi i punës në fushat kritike të angazhimit me qytetarët, mediat, sektorin e shoqërisë civile dhe komunitetin e donatorëve.

Argumenti qendror për zhvillimin e planifikimit strategjik synon të sjellë së bashku përpjekjet e vazhdueshme të COHU për ta bërë edhe më të dukshme punën, si dhe angazhimin mbi çështjet aktuale, së bashku me bashkëpunimin e palëve të interesit dhe fuqizimin në planin organizativ.

Statusi i projekteve aktuale është rishikuar me kujdes për të siguruar që ato po realizohen konform ndryshimeve të vazhdueshme, paralelisht me identifikimin e boshllëqeve të reja që duhet të trajtohen në të ardhmen e afërt.

Krahas projekteve dhe analizës së programeve, stafi ka identifikuar çështje në disa fusha të jetës institucionale, të cilat u përfshinë si objektiva për aktivitetet e ardhshme, të cilat janë dhënë në pjesën e shtyllave themelore.

Gjatë hartimit të planit strategjik, stafi i COHU i ka kushtuar vëmendje përmirësimit të punës në planin e brendshëm si dhe ruajtjes së përgjegjësisë, si vlerë thelbësore e natyrës së organizatës që nga themelimi.

3. Misioni dhe Vizioni

Meqenëse aftësia e COHU për t'iu përshtatur dinamikës dhe tendencave të reja është një vlerë e shtuar për organizatën, çdo dimension i punës së saj lidhet me vizionin e saj të përcaktuar. Vizioni i COHU është ai i një shoqërie që qeveriset përmes institucioneve demokratike dhe funksionale, që promovojnë të menduarit kritik, i cila bazohet në sundimin e ligjit, transparencën dhe gjithë përfshirjen.

Për të kontribuar në përcjelljen e këtij vizioni të së ardhmes, COHU ka mbi vete Misionin e sigurimit të integritetit të institucioneve publike, përmes luftimit të korrupsionit politik dhe krimit të organizuar në të gjitha sferat e shoqërisë.

Vizioni dhe Misioni i organizatës dhe vlerat në të cilat ajo bazon punën e saj, përfaqësojnë thelbin e ndërhyrjes së re strategjike të paraqitur në këtë dokument. Duke pasur parasysh këto dy paradigma, Objektivi i Përgjithshëm i COHU për periudhën e mbuluar në këtë plan strategjik është të luftojë korrupsionin përmes monitorimit të punës së institucioneve dhe avokimit të ndryshimit, integritetit, transparencës dhe llogaridhënies.

4. Dimensionet Kryesore të Angazhimit

Entitetet që përbëjnë planin e ri strategjik përfshijnë tre dimensione kryesore të vendosura në tre shtylla kryesore, siç jepen më poshtë:

a) Dimensioi Konceptual.

Në përshtatje me rrethanat aktuale të operimit, duke qëndruar në përputhje me vizionin dhe misionin, COHU do të angazhohet konceptualisht për të zhvilluar një kuadër të ri të pranisë dhe aktivitetit, i cili përbëhet nga tre elementë kryesorë:

— Interpretimi i formatit të qeverisjes së ligjshme.

Për shkak të një përvoje të konsoliduar, fokusi i ri i COHU-t do të zhvillohet edhe në fushën e interpretimit të qeverisjes së ligjshme, si një gjendje dhe parakusht demokratik, në mënyrë që të identifikojë shkeljen e ligjit në sferën publike dhe ta bëjë atë të dukshme. Ky zhvillim do të ndihmojë COHU-n që të ngrejë shqetësime dhe të nxjerrë udhëzime parandaluese në raport me sjelljen dhe performancën e institucioneve publike.

Pas bazës së konsoliduar të të dhënave për disa fusha, të tilla si patronazhi politik, financimi i partive politike, lidhja midis financimit të subjekteve politike nga kompanitë private me fitimet e këtyre të fundit nga tenderët publik, në këtë interpretim të veçantë, COHU do të jetë në gjendje të japë dhe të lëshojë shqetësime në fushat e konfliktit të interesit, keqpërdorimit të fondeve publike dhe relacionit mes parasë publike me patronazhin politik.

Në mënyrë të ngjashme, ky sektor do të ketë në fushën e tij edhe observimin e zbatimit të ligjeve në fushat e të drejtave të njeriut dhe marrëdhënieve kontraktuale që bien në monitorim dhe kompetencë të institucioneve publike, siç është Inspektorati i Punës, etj.

— Angazhimi për Përmirësimin e Qeverisjes.

Përmirësimi i qeverisjes ka qenë një komponent kyç i punës së COHU-t në të kaluarën dhe do të vazhdojë të jetë një fokus kryesor në orientimin e ri strategjik.

Kjo synon në radhë të parë të nxjerrë në sipërfaqe statusin e performancës së qeverisjes në fushat kryesore të angazhimit të COHU-t.

Ky sektor do të manifestohet përmes hulumtimit dhe publikimeve të analizave të COHU-t mbi politikën dhe praktikën institucionale.

— Rritja e llogaridhënies së institucioneve.

Për shkak të të kuptuarit nga ana e COHU-t të standardeve të performancës së qeverisjes, fokusi i saj do të mbulojë gjithashtu synimin për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike, ndër të tjera në rrethanat e transaksioneve kontraktuale, de politizimin e patronazhit politik, prokurimin publik dhe financat e partive politike, parandalimin e konfliktit të interesit dhe deklarimit të pasurisë.

b) Dimensioi tematik.

Për t'iu përgjigjur dinamikës së re, në planifikimin strategjik, COHU nuk ka zvogëluar fushat tematike të interesit dhe angazhimit, por i ka kushtuar vëmendje një profilizimi më të mirë të tyre.

Fushat tematike të planit strategjik ndahen sipas shtyllave kryesore të COHU, të cilat përfshijnë drejtësinë, anti-korrupsionin, data bazën e të dhënave të hapura, gazetarinë investigative dhe qeverisjen e mirë.

c) Dimensioi strukturor.

Për të mundësuar zbatimin e suksesshëm, koordinimin adekuat me partnerët dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile, si dhe për të ruajtur menaxhimin efikas, në planifikimin strategjik, COHU do të funksionojë me një strukturë të profilizuar, e cila përfshin Zyrën e Zhvillimit, e cila ka përgjegjësinë për zhvillimin e politikës dhe organizatës, Sektori i Gazetarisë Hulumtuese PREPORTR, si dhe struktura tradicionale e qeverisjes së organizatës, e përbërë nga Drejtori Ekzekutiv, Bordi dhe administrata.

5. Shtyllat tematike (Programet)

Plani strategjik parasheh zhvillimin e mëtejshëm të pesë shtyllave tematike që janë pjesë e traditës dhe angazhimit të COHU-t. Ato mbulojnë fushat qendrore të fokusit për të cilat qëndron organizata, përkatësisht drejtësinë, antikorrupsionin, të dhënat e hapura, gazetarinë investigative dhe qeverisjen e mirë.

1

Shtylla e Parë: Drejtësia

Aktivitetet e Drejtësisë dhe monitorimi i gjyqësorit perceptohen nga organizata si vendimtare për luftimin efektiv të krimit të organizuar dhe korrupsionit në institucionet publike. Projektet e Drejtësisë së Hapur, monitorimi i gjykatave mbi rastet e parashkrimit, si dhe identifikimi i rasteve të korrupsionit brenda gjyqësorit do të kryhen brenda kësaj shtylle programi.

Duke ndjekur pikëpamjet dhe analizat e COHU-t, sistemi i drejtësisë në ditët e sotme përballet me shumë sfida, ndër të cilat, lista dominohet nga sa vijon:

- Vonesa në drejtësi, si penale ashtu edhe civile;
- Perceptimet e korrupsionit në gjykata dhe prokurori;
- Keq menaxhimi i rasteve;
- Mungesa e transparencës;

- Mungesa e mekanizmave të duhur për të siguruar përgjegjësinë dhe llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Ndryshimi i ligjeve dhe rregulloreve pa një analizë të duhur dhe mbi baza ad hoc;
- Mungesa e transparencës në procesin e rekrutimit dhe avancimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Mos koordinimi i disa institucioneve të ngritura për arsye të ngjashme;
- Cilësi shumë e ulët e vendimeve gjyqësore;

Brenda këtij kuadri, profilizimi i mëtejshëm i aktiviteteve dhe interesave në shtyllën e drejtësisë do të përbëhet nga elementë si më poshtë:

- Interpretimi i anës strukturore të drejtësisë, i cili përfshin pikëpamjet e COHU mbi strukturën e sistemit të drejtësisë, me një fokus të veçantë në mënyrën se si funksionojnë strukturat, nevojën për struktura dhe mekanizma të rinj dhe nevojat kryesore për të përmirësuar organizimin strukturor të sistemit të drejtësisë.

- Pikëpamjet dhe avokimi në anën organizative, i cili përfshin aspektin e menaxhimit të sistemit, gjykatave, prokurorive, mekanizmave të tjerë, duke u fokusuar në nevojën që strukturat e drejtësisë t'i përgjigjen tendencave bashkëkohore të menaxhimit, ligjeve dhe parimeve universale, sepse ky është një element themelor për funksionimin e një sistemi.
- Avokimi dhe ndryshimi në anën legjislative, i cili përfshin ligjet dhe nismat ligjore, përkatësisht qëndrimet ndaj ligjeve që duhet të rishikohen dhe për çfarë arsye, përfshirë avokimin dhe propozimin për ndryshime legjislative; dhe
- Rishikimi dhe monitorimi i anës cilësore të drejtësisë, që përfshin vendimet gjyqësore, ndihmën juridike, sistemin e mbrojtjes së palëve, si dhe aspekte të tjera që janë parakushte për një drejtësi cilësore, të shpejtë dhe efikase.



Aktivitetet e Drejtësisë dhe monitorimi i gjyqësorit perceptohen nga organizata si vendimtare për luftimin efektiv të krimit të organizuar dhe korrupsionit në institucionet publike.

2

Shtylla e Dytë: Anti-Korrupsioni dhe luftimi i krimit të organizuar

Kjo shtyllë gjithashtu përfaqëson një komponent të rëndësishëm programor të COHU dhe do të përfshijë mes projekteve të tjera që lidhen me deklarimin e pasurisë, parandalimin e konfliktit të interesit, transparencën në financimin e partive politike,

politika më të forta për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme dhe pastrimin e parave.

Brenda kësaj qasjeje, synimi i COHU është të zgjerojë cilësinë e punës së saj jo vetëm në sferën publike, por edhe në fushat ku institucionet publike krijojnë të drejta dhe detyrime ndaj njësive të tjera.

Aktivitetet nën këtë shtyllë do të përfshijnë gjithashtu monitorimin e prokurimit publik dhe atë të privatizimit (likuidimit) të ndërmarrjeve shoqërore në pronësi të mëparshme, si dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Një nga rezultatet kryesore të synuara nga kjo shtyllë e aktivitetit është luftimi i mosndëshkimit.

Brenda këtij kuadri, një profilizim i mëtejshëm i aktiviteteve në këtë shtyllë do të ndahet në kategoritë e mëposhtme:

- Monitorimi i zbatimit të ligjeve organike kundër korrupsionit;
- Avokimi për zbatimin e kritereve dhe standardeve nga institucionet e zbatimit të ligjit;
- Hulumtimi i treguesve të korrupsionit, boshllëqeve, shkeljeve ligjore dhe praktike; dhe
- Vëzhgimi i treguesve të korrupsionit të korporatave.

3

Shtylla e Tretë: OPEN DATA.

Ndërsa aktivitetet e të Databazës së të Dhënave të Hapura do të përfaqësojnë një kontribut të rëndësishëm në përpjekjet e përgjithshme për të luftuar korrupsionin në të gjitha nivelet, në vetvete ajo është konceptuar si një shtyllë e pavarur, për shkak të ndër lidhshmërisë së çështjeve dhe platformave, si dhe shkëmbimit të të dhënave për shtyllat tjera.

Para se të jetë thjeshtë tematike, kjo shtyllë është sistemike dhe është përcaktuar nga forma/metodat e zbatimit, në vend të temave që mbulon. Platforma e të dhënave të hapura do të mbulojnë ndër të tjera financimin e partive politike, politizimin e institucioneve shtetërore, patronazhin politik, vëzhgimin e të ardhurave dhe investimet kapitale, prokurimin publik dhe drejtësinë.

4

Shtylla e Katërt: Gazetaria Hulumtuese

Kjo shtyllë programore e COHU synon të mbulojë një mangësi të theksuar në Kosovë, duke kryer një gazetari investigative kuptimplote dhe profesionale, që ushtron kërkime dhe hetime në lidhje me praktikën korruptive nga zyrtarët institucional në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Aktivitetet brenda kësaj shtylle programore do të kryhen nga stafi i COHUt që kanë ndërtuar një përvojë të

konsiderueshme dhe profesionalizëm në këtë drejtim, përderisa objektivat mbasin që ky staf të rritet në të ardhmen e afërt.

Platforma Preportr e cila sot është ndër burimet më të besuara të informacionit mbi çështjet e korrupsionit, do të mbetet produkti/metoda kryesore e dhënies së rezultateve brenda kësaj shtylle programi.

5

Shtylla e pestë: Qeverisja e mirë

Edhe pse të gjitha shtyllat e lartpërmendura janë të lidhura me qëllimin për të përmirësuar qeverisjen, duke synuar rritjen e transparencës dhe integritet brenda institucioneve publike, kjo shtyllë e veçantë është një angazhim shtesë i COHUt për të sjellë perspektivën e qeverisjes së mirë si një zbatim efektiv i ligjit në çdo fushë.

Në kuadër të këtij programi, projektet që synojnë realizimin e kësaj shtylle do të jenë të dizajnuara për të monitoruar dhe avokuar mbi çështjet kryesore dhe të përditshme të komunitetit, jo të lidhura drejtpërdrejt me aspektin kriminal, por me cilësinë e qeverisjes.

6. Zhvillimi i kapaciteteve dhe pronësia

Në përputhje me kërkesat dhe nevojat e reja që kërkojnë një strukturim të duhur dhe ngritje të kapaciteteve për të zbatuar qëllimet e reja strategjike, COHU do të përqendrohet gjithashtu në grupe funksionale të aktiviteteve për të siguruar zhvillimin e kapaciteteve.

Kryesisht, kjo nënkupton trajnimin dhe përmirësimin e kompetencave të stafit të vet, përfshirjen e studentëve në programet e zhvillimit, hapjen e hapësirës për praktikë më të qëndrueshme dhe afatgjatë, si dhe për profesionistët e gazetarisë dhe Organizatave të Shoqërisë Civile dhe partnerëve, përfshirja e të cilëve do të parashikohet sipas kësaj skeme.

Njëkohësisht, COHU do të përkushtohet për të ndërtuar identitet të qëndrueshëm në shtyllat programore, duke marrë pronësi të plotë dhe aktivizëm funksional.

6.1 Analiza e palëve të interesit

Shtirja e punës dhe angazhimit të COHUT tradicionalisht ka përfshirë njësitë që bien ose si rregullatorë, ose si përfitues, ose si përfitues të zhvillimit të politikave, infrastrukturës ligjore ose vendimmarrjes, konform vizionit dhe misionit të COHUT.

Brenda kësaj linje, plani i ri strategjik për shkak të shtirjes dhe profilizimit ka bërë dhe identifikim të palëve të interesuara, në tri kategori kryesore

si më poshtë: Entet Publike; Subjektet me bazë civile dhe subjektet private;

Brenda kategorisë së Enteve Publike, palët e interesuara të COHU përfshijnë:

a) Institucionet Publike:

- Kuvendi i Kosovës - Komisionet Parlamentare;
- Qeveria - Ministritë;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës - Gjykatat;
- Këshilli Prokurorial i Kosovës - Zyrat e Prokurorisë;
- Komunitat;
- Avokati i Popullit; etj

b) Agjencitë e Pavarura:

- Agjencia Kundër Korrupsionit;
- Organi Shqyrtues i Prokurimit;
- Agjencia Qendrore e Prokurimit;
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik;
- Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë;
- Ndërmarrjet Publike;

c) Subjektet me bazë civile:

- Media;
- Donatorët;
- Organizatat joqeveritare;
- Publiku (qytetarë);

d) Subjektet Private:

- Kompanitë private;
- Studiues dhe ekspertë të pavarur;

Secila nga kategoritë e palëve të interesit kanë linja të përbashkëta interesi dhe përfitimi me punën dhe angazhimin e COHUT, përkatësisht në aspektet si më poshtë:

- Nxitja e analizave dhe rekomandimeve më të mira të politikave;
- Mbledhja dhe shkëmbimi i informacionit mbi proceset dhe praktikat;
- Koordinimi për përpjekjet e përbashkëta për të përmirësuar aspektet kritike brenda ciklit jetësor institucional;
- Zgjerimi i nivelit të njohurive rreth veprimtarisë në qeverisje transparente dhe me integritet;
- Zgjerimi i informacionit drejt qytetarëve dhe nxjerrja në sipërfaqe e opinioneve, vlerësimeve dhe çështjeve të tyre;
- Sigurimi i informacionit të duhur bazuar në prova dhe investigime profesionale;
- Kontributi në një qasje të drejtë dhe transparente ndaj të drejtave dhe detyrimeve të interesave private gjatë procesit të arritjes së këtyre të drejtave nga institucionet publike;
- Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit dhe kulturës politike të qytetarëve ndaj të drejtave dhe përgjegjësive të tyre përballë institucioneve;
- Rritja e nivelit të angazhimit në sektorin e drejtësisë, duke argumentuar dhe avokuar për cilësi në drejtësi; etj

7. Pas Strategjisë

Strategjia e COHUt do të shërbejë si bazë për zhvillimin e Planeve Vepruese Vjetore të organizatës në periudhën pesëvjeçare në vijim. COHU duhet të rishikojë strategjinë çdo vit dhe të përqendrohet në aktivitetet / projektet e realizuara brenda secilës shtyllë programi duke kontrolluar treguesit që mundësojnë monitorimin e progresit.

Treguesit (indikatorët) do të vlerësohen dhe do të shtohen nëse konsiderohen si të rëndësishëm për të vlerësuar më mirë progresin në realizimin e objektivave të COHU. Ky është një dokument dinamik i cili mund dhe duhet të përshtatet me ndryshimin e rrethanave.

Bazuar në aktivitetin / nismat dhe idetë programore të paraqitura në shtyllat kryesore strategjike, COHU do të zhvillojë projekte specifike dhe do të kërkojë financim për të arritur objektivat e saj.

Pas këtij plani strategjik, COHU do të zhvillojë një vlerësim të buxhetit për të gjitha projektet dhe do t'i japë përparësi listës prioritare.

Ky dokument është krijuar nga stafi i COHU dhe pasqyron kornizën dhe pozicionet më të gjera të organizatave si dhe vizionin afatgjatë për zhvillim të qëndrueshëm.

